

KËRKESË
Nr. 6/1, datë 11.2.2022

PËR SHPREHJE INTERESIT (REOI)
TË SHËRBIMIT TË KONSULENCËS “MENAXHIMI I VËLLIMIT TË RECETAVE
TË TESTEVE LABORATORIKE, KUFIRI VJETOR I BUXHETIT TË SPITALIT DHE
TARIFA PËR PAGESAT E PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT”
Asistence teknike ndërkombëtare

Tiranë, 14 shkurt 2022

Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor të Shqipërisë (HSIP)

Nr. huaje: 8466 AL

Numri ID i Projektit: P144688

Titulli i detyrës: Menaxhimi i vëllimit të recetave të testeve laboratorike, kufiri vjetor i buxhetit të spitalit dhe tarifa për pagesat e performancës së shërbimit

Referenca nr.: Ref. nr. HSIP/CS/CQ/11-2020

Qeveria e Shqipërisë po zbaton një program ambicioz për përmirësimin e performancës së sistemit të saj të kujdesit shëndetësor, duke u fokusuar ndër të tjera në cilësinë e shërbimeve të ofruara në spitalet publike.

Shërbimet adekuate diagnostikuese luajnë një rol thelbësor në procesin thelbësor të ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Diagnoza e duhur e një gjendjeje shëndetësore varet shumë nga cilësia e shërbimeve laboratorike. Shërbimet e dobëta laboratorike mund të çojnë në trajtim joadekuat ose të vonuar, me kosto më të larta, që mund të ishin shmangur. Prandaj, aksesit i përballueshëm në shërbime laboratorike cilësore është thelbësor për një sistem të kujdesit shëndetësor, që funksionon mirë, si në aspektin e cilësisë, ashtu edhe në kosto. Përveç kësaj, arritja e përfitimeve të efikasitetit mund të çojë në kosto më të ulëta për njësi dhe përmirësim të aksesit.

IFC-ja është angazhuar nga Qeveria e Shqipërisë (QSH), nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), për të strukturuar dhe për të zbatuar një partneritet publik privat (PPP) për shërbimet laboratorike, që mbulojnë tetëmbëdhjetë spitale rajonale dhe terciare. Objektivi i këtij projekti është të përmirësojë shërbimet laboratorike spitalore publike në Shqipëri, duke tërhequr një partner PPP, për të strukturuar dhe për të operuar rrjetet spitalore të laboratorëve publikë, për të investuar në infrastrukturën e laboratorëve dhe në sistemin e informacionit laboratorik (LIS), futjen e një sistemi të menaxhimit të cilësisë, propozon çmimet, në përputhje me krahasuesit rajonalë.

Studimi i fizibilitetit për PPP-në ka identifikuar një rrezik të konsiderueshëm fiskal, të lidhur me vëllimin e analizave të përshkruara nga mjekët e spitaleve publike. Ky rrezik lidhet me pasigurinë aktuale të vëllimit (statistikat për numrin e testeve të kryera nuk janë të besueshme) dhe me evoluimin e modeleve të recetave, kur lista e plotë e testeve është e disponueshme në spitale.

MSHMS-ja ka nevojë për asistencë teknike për të zhvilluar protokollet e recetave laboratorike për diagnostikimet më të shpeshta, si dhe për të vendosur rregulla burokratike për të kontrolluar përshtatshmërinë e recetave për testet laboratorike, një hap shumë i nevojshëm në sigurimin e kontrollit fiskal të projektit dhe kufizimin e keqpërdorimit/mbipërdorimit të laboratorit: testet.

Objektivi i përgjithshëm i detyrës është të ofrojë asistencë dhe të zhvillojë kapacitetet e MSHP-së dhe të spitaleve për të trajtuar në mënyrë adekuate rrezikun e keqpërdorimit/mbipërdorimit të testeve laboratorike dhe për këtë arsye të qëndrojnë brenda kufijve të autorizuar të buxhetit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore janë:

Objektivat specifike të asistencës teknike përbëhen nga:

1. Rishikimi i formularëve të porositjes, në përputhje me gamën e testeve të disponueshme në spitalet publike, në përputhje me Marrëveshjen e Koncesionit të PPP-së Lab, duke identifikuar të ashtuquajturat teste emergjente.

2. Zhvillimi i udhëzimeve/protokolleve shqiptare për recetën e testeve laboratorike, si dhe i rregullave burokratike të vendosura për të racionalizuar recetat për testet laboratorike, duke përfshirë:

3. Rekomandimi i një sistemi monitorimi për udhëzimet/protokollet, duke përfshirë rolet e detajuara, aktivitetet, detyrat dhe planin e veprimit për MSHP-në, drejtuesit e spitaleve, drejtuesit e departamenteve dhe specialistët e laboratorëve për të kontrolluar përputhjen me udhëzimet/protokollet e recetave.

4. Rekomandimi i një strategjie zbatimi në MSHP, duke përfshirë:

5. Zhvillimi i modelit të trajnerit dhe trajnimi i valës së parë të trajnerëve.

6. Vlerësimi i zbatimit të të gjitha aktiviteteve në 3 dhe 6 muaj dhe rekomandimi se si të përmirësohet pajtueshmëria.

7. Rivlerësimi i udhëzimeve/protokolleve në 6 muaj në dritën e praktikës së përshkrimit dhe kufizimeve buxhetore për testet laboratorike.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kërkon konsulentë ndërkombëtarë për të kryer këtë detyrë, të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Konsulenti duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

Kualifikimet e kompanisë konsulente:

- Shoqëria konsulente duhet të ketë së paku dhjetë vjet përvojë në ofrimin e shërbimeve konsulente në sektorin e shëndetësisë.

- Firma konsulente duhet të ketë të paktën 1 kontratë të ngjashme në zhvillimin e protokolleve të recetave laboratorike për diagnostikimet më të shpeshta dhe në vendosjen e përshtatshmërisë së kontrollit të recetave për analizat laboratorike.

- Kompania duhet të ketë përvojë në projekte ndërkombëtare dhe përvoja në rajon do të jetë përparësi.

- Eksperiencë në mbështetjen e organizatave të shëndetit publik ose të shoqërive mjekësore në punimet përkatëse, duke ofruar referenca të një pune të tillë në vende me mjedise të krahasueshme me Shqipërinë.

- *Kompania konsulente duhet të ketë një ekip ekspertësh për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve në bazë të këtyre ToR-ve:*

- Udhëheqës ekipi me 10 vjet përvojë konsultimi në forcimin e operacioneve laboratorike spitalore, duke përfshirë proceset e recetave, menaxhimin e cilësisë dhe LIS-së.

- Ekipi duhet të përfshijë specialistë me doktoraturë në shkencën laboratorike dhe/ose mjekë të specializuar në biokiminë mjekësore ose specialitete të tjera laboratorike përkatëse, të kenë përvojë të mëparshme në hartimin e udhëzimeve dhe/ose të protokolleve.

- Një specialist mjekësor (rekomandohet).

Firma e cila do të zgjidhet (pas plotësimit të kërkesave minimale të kualifikimit/përvojës më lart), si e renditur më lart në bazë të kriterëve të vlerësimit/listës së shkurtër më poshtë, do të ftohet për negociata për kontratën, gjatë së cilës, firmave të suksesshme do t'u kërkohej të përmbushin çelësin e mësipërm: kualifikimi i personelit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes Njësisë së Koordinimit të Projekteve (NJKP) tani fton kompanitë e kualifikuara të konsulencës (Konsulentët) të tregojnë interesin e tyre për ofrimin e Shërbimeve. Kompanitë Konsulente duhet të ofrojnë informacion që tregon se ato

kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer Shërbimet (siç përshkruhet më sipër). Kriteret e vlerësimit/përzgjedhjes janë:

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikët
1	Përvoja e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e aktivitetit	30 pikë
2	Numri i kontratave të lidhura me detyrën e përfunduar gjatë pesë vjetëve të fundit	60 pikë
3	Disponueshmëria e stafit kyç të kualifikuar brenda firmës	10 pikë
TOTAL		100 pikë

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet në paragrafin 1.9, të udhëzimeve të Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore* (janar 2011, rishikuar në korrik 2014), duke përcaktuar politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është: **Kualifikimi i Konsulentit (CQ)**, në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimet e Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të IBRD-së dhe kredive, dhe granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore* (janar 2011, rishikuar korrik 2014).

Konsulenti duhet të jetë një firmë ndërkombëtare. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është Kualifikimi i Konsulentëve (CQ) në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimet e Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të IBRD-së dhe kredive, dhe granteve të IDA-së nga huamarrësit e Bankës Botërore* (janar 2011, rishikuar në korrik 2014). Kontrata do të jetë *lump sum*.

Detyra duhet të kryhet brenda 10 muajve nga nënshkrimi i kontratës. Inputi total i vlerësuar në ditë pune është: rreth 80 ditë pune.

Informacione të mëtejshme mund të merren në adresën e mëposhtme, gjatë orarit të punës nga ora 08:00 deri në 16:30 (e hënë në të enjte) dhe nga ora 08:00 deri në 14:00 të premten në adresën e mëposhtme. Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (personalisht, me postë ose me *e-mail*) deri më **28 shkurt 2022**.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Adresa: Rruga e Kavajës nr. 53, Tiranë – Shqipëri

Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU)

Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor (HSIP)

Att: Blerina Dudushi

E-mail: hsip.dudushi@gmail.com

BlerinaDudushi@shendetesia.gov.al

**REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (REOI)
(CONSULTING SERVICES)
INTERNATIONAL TECHNICAL ASSISTANCE – CONSULTING COMPANY**

Tirana, 14th of February 2022

Albania Health System Improvement Project (HSIP)

Loan No: 8466 AL.

Project ID Number: P144688

Assignment Title: Managing the Volume of Laboratory Test Prescriptions, Annual Hospital Budget Caps and Fee for Service Performance Payments

Reference No.: Ref. No. HSIP/CS/CQ/11-2020

The Government of Albania is implementing an ambitious program to improve the performance of its health care system, focusing among other issues on the quality of services provided in public hospitals.

Adequate diagnostic services play an essential role in the core process of health service delivery. The right diagnosis of a health condition largely depends on the quality of laboratory services. Poor laboratory services could lead to inadequate or delayed treatment with related higher costs that could have been avoided. Therefore, affordable access to quality laboratory services is essential for a well-functioning health care system both in terms of quality and cost. In addition, achieving efficiency gains could lead to lower unit costs and improved access.

IFC has been engaged by the Government of Albania (GoA), through the Ministry of Health and Social Protection (MoHSP), to structure and implement a public private partnership (PPP) for Laboratory Services covering eighteen Regional and tertiary hospitals. The objective of this project is to improve public hospital laboratory services in Albania by attracting a PPP partner to structure and operate a hospital networks of public labs, to invest in laboratories infrastructure and laboratory information system (LIS), introduce a quality management system, propose prices in line with regional comparators.

The Feasibility Study for the PPP has identified a substantial fiscal risk linked with the volume of tests prescribed by the medical doctors of the public hospitals. This risk is related to the current volume uncertainty (statistics on number of tests performed are unreliable), and the evolution of prescriptions patterns when the full list of tests is available in the hospitals.

The MoHSP needs technical assistance to develop laboratory prescription protocols for most frequent diagnostics, as well as set bureaucratic rules to control appropriateness of the prescriptions for laboratory tests, a much needed step in ensuring fiscal control of the project, and limiting misuse/overuse of laboratory tests.

The overall objective of the assignment is to provide assistance and develop capacity of the MoHSP and hospitals to adequately address the risk of misuse/overuse of lab tests and therefore to remain within authorized budget limits.

The main duties and responsibilities are:

The specific objectives of the technical assistance consist of:

1. Reviewing ordering forms in line with the range of tests available at public hospitals, in line with the Lab PPP Concession Agreement, identifying the so-called Emergency Tests.
2. Developing Albanian laboratory test prescription guidelines/protocols, as well as bureaucratic rules set to rationalize prescriptions for laboratory tests, including:
3. Recommending a monitoring system for the guidelines/protocols, including detailed roles, activities, tasks and action plan for the MoHSP, hospital managers, heads of departments and laboratory specialists to control compliance with prescriptions guidelines/protocols.
4. Recommending an enforcement strategy to the MoHSP, including:
5. Developing a train the trainer model and training the first wave of trainers.
6. Evaluating implementation of all activities at 3 and 6 months and recommending how to improve compliance.
7. Re-evaluating guidelines/protocols at 6 months in light of prescribing practice and budgetary constraints for laboratory tests.

The Ministry of Health and Social protection is seeking for international consultants to conduct this assignment which fulfill the following criteria:

The consultant must meet the following requirements:

Qualifications of the Consulting Company:

- The consulting company must have at least ten years of experience in providing consulting services in health sector.
- The consulting firm must have at least 1 similar contract in developing laboratory prescription protocols for most frequent diagnostics, and in setting control appropriateness of the prescriptions for laboratory tests.
- The company must have experience in international projects, and experience in the region shall be an advantage.
- Experience in supporting public health organizations or medical societies in relevant works, providing references of such work in countries with settings comparable to Albania.
- *The consulting company must have a team of experts to support the implementation of activities under this ToRs:*
- Team Leader with 10 years of consulting experience in strengthening hospital laboratory operations, including prescription processes, quality management and LIS.\
- Team should include specialists with PhD in Lab Science and/or medical doctors specialized in medical biochemistry or other relevant labs specialty, having previous experience in drafting guidelines and/or protocols
- One medical specialist (recommended)

The firm who will be selected (after fulfilling the minimum qualification/experience requirements above) as highest ranked based on the evaluation/shortlisting criteria below, will be invited for contract negotiations, during which, the successful firms will be required to fulfill the above key staff qualification.

The Ministry of Health and Social Protection, through Project Coordination Unit (PCU) now invites eligible consulting companies ("Consultants") to indicate their interest in providing the Services. Consulting Companies should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services (as described above). The evaluation/shortlisting criteria are:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	Overall experience of the firm (number of years) in the field of assignment	30 points
2.	Number of assignment-related contracts completed during last five years.	60 points
3.	Availability of qualified key staff within the firm	10 points
TOTAL		100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's [Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers](#) (January 2011, revised July 2014), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest. . The selection method to be applied is **Consultant Qualification (CQ)**, in accordance with the procedures set out the World Bank's *Guidelines Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers*" (January 2011, revised July 2014).

The consultant should be an International Firm. The selection method to be applied is Consultants Qualification (CQ) in accordance with the procedures set out the World Bank's Guidelines Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers" (January 2011, revised July 2014). The contract will be Lump Sum.

The assignment should be performed within 10 months since the contract signature. The total estimated input in man days is: around 80 man days

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday In the address below). Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by e-mail) by **28th of February 2022**.

Ministry of Health and Social Protection
Adress: Rruga e Kavajës No. 53, Tirana – Albania
Project Coordination Unit (PCU)
Health System Improvement Project (HSIP)
Att: Blerina Dudushi
E-mail: hsip.dudushi@gmail.com
BlerinaDudushi@shendetesia.gov.al